



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:038970
Datë: 13.11.2018
Numri i dokumentit: 00172538

P.nr. 980/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ – Departamenti i përgjithshëm Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Adem Shabani, me procesmbajtësen zyrtaren ligjore Kadishe Shabani, në lëndën penale kundër të akuzuarit D.I, me vendbanim në fshatin..., Komuna Ferizja, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 8 lidhur me paragrafin 6 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.1108-5/18, të datës 16.07.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestarë publikë, në prezencën e Prokurorit të shtetit Avdullah Abedini, të akuzuarit D.I, me mbrojtësin e tij me autorizim av.V.M nga Ferizaj dhe e dëmtuara B.SH me përfaqësuesin e saj ligjor prindin B.Sh me datë 13.11.2018, morri dhe shpalli publikisht këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari D.I, nga fshati...,Komuna Ferizaj, lindur me datë... në të njëtin vend, nga i ati B., e ëma Xh., e gjinisë M..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së mesme ekonomike, numër personale të letërnjoftimit..., mbrohet në liri,

ËSHTË FAJTOR

Sepe - me datën 21.05.2018, rreth orës 10:10, duke lëvizur në rrugën lokale “ Dëshmorët e Kombit „nga drejtimi I rrethit të FSK-së, në drejtim të qendrës pikërisht me të arritur përballë teatrit “Ardiana Avdullahu “, duke drejtuar automjetin, e markës “ Opel Zafira ”,ngjyrë hiri, me targa të regjistrimit..., nga pakujdesia e në kundërshtim me dispozitat e nenit 53 dhe nenit 151 të Ligjit Rrugor të Trafikut, ka rrezikuar jetën e njerëzve dhe pasurin e tyre, në atë mënyrë që duke mos i kushtuar kujdes të veçantë pjesëmarrëseve tjerë në trafik në rastin konkret këmbësorëve, e cila në atë moment e kishte filluar kalimin e rrugës nga ana e djathtë në anën e majtë, ku me pjesën e përparme të automjetit e godet të miturën B.SH, fillimisht në ekstremitet e poshtme duke vazhduar me kontaktin sekondar mbi bulojnë e motorit ku në këtë aksident, lëndime të rënda trupore ka pësuar e mitura B.SH, me pasoja të përkohshme për shëndetin të përshkruara si në ekspertizën mjeko ligjore të datës 17.06.2018,-

- me çka kreu veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4, 7, 41, 42, 43, 45, 46,47,73, 74, 75, par.1 nenpar.1.3, te KPRK-së, dhe neneve 365 dhe 450 të KPPRK-së të akuzuarit i shqipton:

DENIM ME BURG

Ne kohëzgjatje prej 6 /gjashtë / muajve.

Duke aplikuar nenin 47 te KPRK-së, me pëlqimin e te akuzuarit, dënimi i shqiptuar me burgim ne kohëzgjatje prej 6 /gjashte/ muajve, zëvendësohet me dënim me gjobe ne shumen prej 400 / katërqind / €uro, te cilin dënim me gjobe është i obliguar të paguaje ne afatin ligjor prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron apo nuk do te mund te paguaje dënimin me gjobe, i njëjti dënim do ti zëvendësohet me dënim burgu duke llogaritur për çdo 20 euro 1 ditë burgim.

E dëmtuara B.SH me përfaqësuesin e saj ligjor prindin B.Sh nga Ferizaj me

vendbanim në rrugën....,nr..... për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt civilo-juridik.

I akuzuari obligohet që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, në emër të ekspertizës te komunikacionit rrugor shumen prej 40,88 Euro, në emër të ekspertizës mjeko ligjore 20,00 Euro, dhe në emër te shpenzimeve te paushallit gjyqësor shumen prej 30,00 Euro, gjithsej në shumë prej 90,88Euro. të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarrimit të dhunshëm

Obligohet i akuzuari të paguaj taksën në shumën prej 30 Euro, konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.1108-5/18, të datës 16.07.2018, e ka ngarkuar të akuzuarin D.I, me vendbanim në fshatin., Komuna Ferizja, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 8 lidhur me paragrafin 6 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPK-së me dt.13.11.2018, ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit i PTH Ferizaj Avdullah Abedini, i akuzuari D.I, me mbrojtësin e tij me autorizim av.V.M nga Ferizaj dhe e dëmtuara B.SH me përfaqësuesin e saj ligjor prindin B.Sh.

Në shqyrtimin fillestar gjyqtari ka konstatuar se i akuzuari në afatin ligjor me kohë së bashku me ftesën për shqyrtim, ka pranuar edhe një kopje të aktakuzës, ku edhe mbrojtësit i tij nga i mbrojturi i tij ka pranuar aktakuzën.

Në fillim të shqyrtimit fillestar i akuzuari është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të drejtat e të akuzuarit janë respektuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën të akuzuarit.

Gjyqtari gjykues është bindur se i akuzuari pas leximit të aktakuzës dhe konsultimin me mbrojtësin e tij e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, të njëjtit i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari D.I, në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e ndien veten fajtorë dhe e

pranon e pranoj fajësinë për veprën penale për të cilën më ngarkon aktakuza i kërkon falje të dëmtuarës B... dhe përfaqësuesin e saj ligjor prindin B.Sh, për rastin që ka ndodhur, dhe shëmimin e saj pa pasoja dhe në vazhdim ka theksuar se atë ditë ishte duke lëvizur nga rrethi i FSK-së në drejtim të qytetit dhe kur ka arritur përballë Shtëpisë së Kulturës për një moment vetëm kur ka parë se i ka dal përpara veturës një këmbësore shumë afër dhe menjëherë ka frenuar por nuk ka mundur që ta ndal veturën në vend dhe me pjesën e parë e kam goditur në anën e djathtë dhe shpejtë ka ndalur nga vetura dhe e kemi thirr emergjencën dhe është dërguar për ndihmë të parë, duke i premtuar gjykatës që në të ardhmen do të jem me i kujdesshëm dhe nuk do të përsëris këtë lloj të veprës penale, dhe me rastin e shqiptimit të dënimit gjykata të merë për bazë theksimet e cekura më lart.

Gjyqtari në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPK-së, është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit.

Pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë.

Prokurori shtetit Avdulla Abedini në shqyrtimin fillestar në mendimin e kërkuar nga gjyqtari gjykues ka deklaruar pasi i pandehuri pranon fajësinë për veprën penale që akuzohet dhe vetë i pandehuri në shqyrtimin e sotëm fillestar e elaboroj gjendja faktike e përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës ishte konstatuar drejt e po ashtu provat në të cilat është bazuar aktakuza ishin prova të besueshme dhe prova të pranueshme e të mjaftueshme që dëshmuan me vetë pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili pranim është bërë në përputhje të plotë me kuptim të dispozitave të nenit 248 të KPRK-ës, pranim i cili ka mbështetje të plotë në prova materiale të cilat i përmban aktakuza. Prokurorja e shtetit konsideron se gjykata duhet të ketë parasysh rrethanat, vendin dhe ambientin në të cilën ka ndodhur aksidenti, e po ashtu duhet të ketë parasysh edhe rrethanat tjera si ato lehtësuese i propozon gjyqtarin gjykues duhet që të ketë parasysh pendimin e thellë të akuzuarit si dhe premtimin se i njëjti nga dita kritike për shkak të rastit që ka ndodhur sot ka probleme shëndetësore, andaj propozoj gjyqtarit gjykues që të merr vendim meritator sipas ligjit.

Mbrojtësi i të pandehurit D.I me autorizim Av.V.M, në shqyrtimin fillestar pajtohet me pranimin e fajësisë, pasi pranimin e ka mbështetur në theksimet e cekura më lart me rastin e pranimin të

fajësisë andaj i propozoj gjykatës që me rastin e shqiptimit të sanksionit penale të merr të gjitha rrethanat lehtësuese.

Përfaqësuesi ligjor B.Sh prindi i të dëmtuarës B.. në shqyrtimin fillestar deklaroi se nuk i bashka ngjitet ndjekjes penale kurse mbetet pranë kërkesës pasurore-juridike.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vetëtuar se i akuzuari pranimin e fajësisë e ka mbështet në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale si mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit i dt. 17.06.2018, ekspertiza e ekspertit të mjekësisë-ligjore i dt.17.06.2018,raporti mjekësor nga Qendra Emergjente në Ferizaj të dt.21.05.2018, shqimi i fotografive të cilat gjenden në shkresat e kësaj lënde penale.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet e veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 8 lidhur me par.6 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të dënimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese në kuptim të nenit 73 të KPK-se të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, duke gjetur si rrethana posaçërisht rënduese, shkallen e përgjegjësisë penale, intensitetin e rrezikimit, si dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra, se me veprën penale rrezikim i trafikut publik, të kryer nga ana e të akuzuarit, kemi të bëjmë rrezikimin e shëndetit të njeriut, në rastin konkret të dëmtuarës fëmijës B.SH, e si rrethane lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, pendimi i thellë i tij, kujdesin për të dëmtuarën që ka pësuar nga ky aksident, kërkim falje ndaj familjes së të dëmtuarës, gjer me tani i pa gjykuar, çka nënkupton se nuk ka ardhur ndesh me rregullat pozitive, si rrethane posaçërisht lehtësuese për të akuzuarin është marrë pranimi i fajësisë, andaj gjykatapas shpalljes së aktgjykimit me aplikimin e nenit 47 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij me autorizim Av.V.M, dënimi i shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 6/gjashtë/ muajve, zëvendësohet me dënim me gjobe në shumën prej 400/ katërqind / Euro, në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që i akuzuari të mos kryejë vepra penale si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj vepre penale në shoqëri konform nenit 41 të KPRK-së.

Bazuar nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.të KPPK-së, e dëmtuara B.SH me përfaqësuesin e saj ligjor prindin B.Sh nga Ferizaj me vendbanim në rrugën... ,nr..., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në procedurë civile

Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së dhe nenit 39 parag.1 nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e viktimave të krimit Nr.05/L-036.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal,

P.nr.980/2018 me datë 13.11.2018

Zyrtare ligjore
Kadishe Shabani

Gjyqtari
Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundë të ushtrohet, ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.